



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	20.10.2025
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor – Shtator 2025

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.09.2025 deri 30.09.2025.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN SHTATOR 2025

1. Përmbledhje ekzekutive

QKMF në Lipjan është duke bërë përgatitjet për ofrimin e 48 analiza/testeve laboratorike. Në muajin tetor pritet të pajiset Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan me një Analizator Biokimik/Imunokimik. Ky aparat do të ofroj edhe 5 analiza të reja laboratorike për diagnostikimin e sëmundjeve të tiroides përmes ofrimit të analizave si: TSH, T3, T4, Anti-TPO, Anti-TG.

Kjo iniciativë do të ndikoj drejtpërsëdrejti në përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore, në mirëqenien dhe shëndetin publik të qytetarit.

Më tutje, në këtë muaj, QKMF në Lipjan është pajisur edhe me një Ultrazë të teknologjisë së avancuar. Ky aparat shumë i rëndësishëm në avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve diagnostike është bashkëfiancuar nga Komuna e Lipjanit dhe projekti AQH.

Për përdorimin e ultrazërit janë trajnuar paraprakisht nëntë mjek. Tani kemi dhjetë mjek të trajnuar për ofrimin e këtij shërbimi.

Të gjitha shërbimet shëndetësore janë ofruar pa ndërprerje dhe janë mbuluar me personel të mjaftueshëm mjekësor.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar edhe në këtë muaj.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara, bazuar në Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024

Kemi bërë të gjitha përgatitjet për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit për muajin tetor 2025. Është hartuar lista e aktiviteteve të cilat do të organizohen gjatë muajit të ardhshëm.

Shërbimet e Maternitetit dhe Stomatologjisë kanë vazhduar përkohësisht të ofrojnë shërbime në objektin e Komunes, në rrugën Isa Olluri.

Në bazë të raporteve nga intervenimi i shërbimit të urgjencës të pranuar nga QKMF, në muajin shtator janë shënuar 34 aksidente trafiku. Krahasuar me muajin e kaluar, numri i rasteve të aksidenteve në trafik në këtë muaj ishte dukshëm më i ulët, 27 raste më pakë se në muajin paraprak.

Shuma e të hyrave të inkasuara nga participimi në muajin shtator ka qenë 10,055.00 €. Totali i të hyrave të realizuara për periudhën Janar-Shtator 2025 është 72,466.00 €.

Përqindja e referimeve të jashtme për në shërbimin sekondar dhe terciar dhe sekondar gjatë këtij muaji ka qenë 10.56% . Kjo përqindje, siç është raportuar nga QKMF, vazhdon të mbetet në kuadër të përqindjes së lejuar për referimet nga KPSH.

3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Shtator janë kryer 43908 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Stafi mjekësorë	Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithsej
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i mjekësisë së Përgjithshme 20	11	9	20
Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatrisë	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 84 Bachelor=29	17	96	113
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5
Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulet-4	12	11	23
Punëtor në administratë	Shkollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Numri i punësuarve nga komuniteti jo shumice	Shkolla e mesme-3	1	2	3
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Filllore- 2 Shkolla e mesme-2	3	1	4

Gjithsej numri i punëtorëve	Shkollim superior =64, Shkollim bachelor =33, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesëm i ulët = 4	90	148	238
------------------------------------	--	----	-----	-----

Totali i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në muajin Shtator 2025:

Shtator 2025-Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në QKMF	7105
2	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në Punte	5040
3	Vizita mjekësore Pediatrike	456
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	354
5	Vizita mjekësore Stomatologjike	761
6	Vizita mjekësore Pulmologjike	30
7	Vizita mjekësore Emergjente	5042
8	Vizita në kujdesin Paliative	225
9	Total	19013

Shtator 2025- Shërbime Shëndetësore

1	Injeksione	7337
2	Infuzione	4090
3	Pastrim lidhje	1723
4	RTG	575
5	Laborator	2557
6	Lindje	0
7	Largim i penjve	111
8	Imobilizime	42
9	Oksigjenoterapi	75
10	EKG	474
11	Mamografi	19
12	USG	157

13	Vizita Shtëpiake me Autoambulancë	142
14	Transport me Autoambulancë	78
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendrën e Azilit - Magure	3
17	Vizita në Qendrën e Paraburgimit	22
18	Rrahje	1
19	Këmbësor i lënduar me automjet	0
20	Konstatim vdekje	11
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	0
23	Aksidente trafiku	34
24	Dhunë familjare	5
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	3855
27	Vaksina	714
29	Shërbime stomatologjike	725
30	Referime	2009
31	Inhalime	11
32	Vizita infermieri gjinekologjike	29
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	45
34	Klasa për nëna	51
33	Gjithsej shërbime	24895

4. Qendra për Punë Sociale QPS

Të dhënat numerike për numrin e klientëve dhe shërbimeve në aspektin e klientëve dhe shërbimeve të asistencës në raste dhe për ndihmë sociale gjatë muajit Shtator 2025.

Tab. 1. Shërbimin Social: Shërbimet dhe klientët.

Klientët		Shërbimet	
----------	--	-----------	--

	Numri i rasteve		Numri i rasteve
<i>Fëmijë me sjellje asociale</i>	16	<i>Shërbime për të moshuarit</i>	
<i>Të mitur konflik. ligjin</i>	19	<i>Vendosja në strehim familjar</i>	4
<i>Kujdestari për fëmijet e pa shoqëruar</i>		<i>Këshillim për bashkshort në martesë</i>	8
<i>Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindrore</i>		<i>Shërbime për të mitur në konflikt me ligjin</i>	19
<i>Martesë të parakohshme</i>	2	<i>Besim i femijeve dhe mbikqyerje e vizitave prindërore</i>	8
<i>Klientë në nevojë për kshillime</i>	4	<i>Vendosja në strehim për viktimat e dhunës</i>	
<i>Klient tjerë në nevojë për shërbime</i>		<i>Shërbime për të rritur me AK.</i>	
<i>Klient me aftësi të kufizuar - fëmijët</i>		<i>Shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar</i>	
<i>Viktima të vendosura në strehimore</i>		<i>Sanim i marrëdhënieve familjare</i>	1
<i>Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve</i>		<i>Këshilla psiko-sociale</i>	
<i>Viktimat e dhunës në familje</i>		<i>Ndimë materiale për fëmijet me aftësi të kufizuar</i>	
<i>Fëmijë të keqtrajtuar-abuzuar (lënë pas dore)</i>		<i>Intervenim i viktimave gjatë kujdestarisë</i>	1
<i>Të moshuarit në nevojë për shërbime</i>	1	<i>Intervenimet e përgjithshme</i>	
		<i>Numri i përgjithshëm i shërbimeve</i>	

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej
APLIKIMI	1. Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë.	1	2	3
	Sa prej tyre janë të aprovuara	0	2	2
	Sa janë në shqyrtim	1	0	1
	Sa prej tyre janë të refuzuara	0	0	0
RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.	9	10	19
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.	41	48	89
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.	3	4	7

VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara	41	48	89
	Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je odobreno	41	48	89
	Sa prej tyrjanërefuzuar/çregjistruar	3	0	3
KOM.MJEKESOR	4. Numri i rasteve të dërguara. në Komision Mjekësor (KM)	53	0	53
	Numri i rasteve të aprovuara nga KM	34	0	34
	Numri i rasteve të refuzuara nga KM.	5	0	5
	Numri i rasteve të kthyrë nga KM për kompletim dokumentacioni	14	0	14
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit	0	0	0
	A. Në shkallë të parë(I) Na prvi stepen (I)	0	0	0
	B. Në shkallë të dytë(II) Na drugi stepen (II)	0	0	0
	Numri i ankesave të aprovuara	0	0	0
	Numri i ankesave të refuzuara	0	0	0
	Numri i ankesave në shqyrtim	0	0	0
	Kontestet në Gjykata	0	0	0
	a) Kontestet të pranuar	0	0	0
	b)Konteste të refuzuara	0	0	0

5. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij muaji në përgjithësi ka qenë e mirë.

6. Investimet Kapitale

Projekti Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

Projekti Rregullimi i Infrastrukturës së Jashtme të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

7. Vështirësitë dhe sfidat

- Furnizimi me barna dhe materiale nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i pjesshëm dhe nuk ka arritur të mbulojë të gjitha nevojat.
- Punimet ndërtimore për objektin e ri kanë ndikuar në zvogëlimin e hapësirave të disponueshme për punë, duke krijuar sfida në organizimin e shërbimeve.

8. Planifikimi për muajin Tetor 2025

Në muajin tetor do të zbatohen aktivitetet për promovimin dhe edkimin shëndetësor kundër kancerit të gjitrit, shënimi i muajit rozë.

Do të vazhdohet me edukimin profesional të vazhdueshëm të stafit mjekësor, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore.